



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

Datë: 3 nëntor 2020

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafi 1.3 dhe nenit 5 paragrafët 2, 4, 5 dhe 6 të Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës dhe në bazë të Vendimit KPK/Nr. 536/2020 shpall:

**KONKURS**

**Për emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit**

- I. Kandidatët e interesuar për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - 1.1 Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
  - 1.2 Të mos ketë të ngritur aktakuzë;
  - 1.3 Të mos jetë i dënuar për vepër penale;
  - 1.4 Të ketë vlerësim pozitiv të performancës në tri vitet e fundit;
  - 1.5 Të mos ketë të shqiptuar sanksion disiplinor në pesë vitet e fundit, duke përfshirë qortimin dhe vërejtjen jo publike;
  - 1.6 Të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral;
  - 1.7 Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë si prokurorë, nga të cilat tre (3) vjet si prokurorë në Departamentin për të Mitur ose në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore ose në PSRK.
- II. Kandidatët e interesuar për Kryeprokurorë të Prokurorisë së Apelit duhet të plotësojnë: formularin për aplikim, formularin për vetëvlerësim dhe formularin e koncept dokumentit të cilat janë të publikuara në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës, autobiografinë (CV), dhe çfarëdo dokumenti tjetër relevant për të dokumentuar përvojën e tyre përfshirë rekomandimet.
- III. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon kandidatët e gjinisë femërore dhe kandidatët nga komunitetet jo shumicë që i plotësojnë kriteret e lartë cekura, që të aplikojnë për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.
- IV. Konkursi do të jetë i hapur nga data **4 nëntor 2020 deri më 18 nëntor 2020**.
- V. Aplikacioni, së bashku me të gjitha dokumentet e bashkangjitura, duhet të dorëzohen te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e pestë (5) të ndërtesës së Prokurorit të Shtetit, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 505, të mbyllura në zarf, ose me postë.